



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:105643  
Datë: 25.09.2024  
Numri i dokumentit: 06210119

**PA1.nr.734/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryetari i kolegjit, Violeta Husaj Rugova dhe Skender Çoçaj anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes Gjyqësore në cilësi të procesmbajtëses Fitore Zeka, në çështjen penale ndaj të akuzuarit G. S., për shkak të veprës penale: Ngacmimi nga neni 186 paragrafi 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. Nadire Koshi dhe dhe Millosh M Deleviç, të paraqitur kundër aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, P.nr.138/2019 të dt. 05.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit G. S., av. N. K. dhe M. M. D., ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, P.nr.138/2019 të dt. 05.04.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, P.nr.138/2019 të dt. 05.04.2024, i akuzuari G. S. është shpallë fajtorë për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 186 paragrafi 3 të KPRK-së dhe është gjykuar: me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit. Gjykata në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej katër (4) muajve, i zëvendëson në: dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro, të cilin dënim - gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t’ia zëvendësoj në dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor

të paguaj shumën prej tridhjetë (20) euro, po ashtu edhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pala e dëmtuar D. S., për kërkesën pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko - civil.

Kundër këtij aktgjykimi të cekur si më lartë, në afat ligjorë ankesë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit av. N. K. me datë 07.06.2024 dhe av.M. M. D. nga Mitrovica, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar P.nr.138/2019 të dt.05.04.2024 ta ndryshoj ashtu që të pandehurit ti shqiptoj një dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.736/2024, datë 14.05.2024, ka propozuar që të refuzohen si e pa bazuara ankesat e parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarit dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e apelit pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekuar në ankesa gjeti se :

#### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Aktgjykimi i ankimuar nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPP-së, apo shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

-Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit janë: mbrojtësja av. N. K. pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nuk është i drejtë dhe nuk është në harmoni me peshën e veprës penale për të cilën akuzohet dhe se dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës penale por në këtë rast gjykata ka bërë shkelje të nenit 73 pika 2 të KPRK-së. Ndërsa mbrojtësi av. M. M. D. pretendon se gjykata nuk i ka marrë mjaftueshëm parasysh pendimin e të akuzuarit dhe pranimin e fajit si rrethana lehtësuese, se kanë kaluar 9 vite nga kryerja e veprës penale, bashkëpunimin vullnetar me organet e ndjekjes, sjelljen korrekte pas konfliktit me viktimën, se i akuzuari dhe i dëmtuari janë pajtuar.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin në raport me pretendimet ankimore, Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mbrojtësve të akuzuarit, për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal 04/L-082, i cili ishte në fuqi gjatë kohës së kryerjes së veprës penale, ashtu që si rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë ka marrë parasyshë shkallën e përgjegjësisë penale, dashjen e tij, përgjegjësinë dhe

përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë vepër penale faktin se vepra penale ishte kryer gjatë një periudhe kohore prej dy viteve. Ndërsa, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari, i njëjti ka treguar sjellje të mirë në gjykatë, keqardhjen e shprehur për rastin e ndodhur dhe premtimin e dhënë para gjykatës së më nuk do të përsërisë veprime të tilla, faktin se nga kryerja e veprës penale kanë kaluar pothuajse nëntë (9) vite. Bazuar në të lartcekurat e veçanërisht në pranimin e fajësisë Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar dispozitën e nenit 75 të KPRK-të të zbutjes së dënimit, ashtu që i ka shqiptuar dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër. Me rastin e zbutjes së dënimit gjykata e shkallës së parë i ka respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 76 par.1, nën-par. 1.5 të KPRK-së, ashtu që ka zbutur dënimin nën minimum dhe i ka shqiptuar fillimisht dënimin me burg 4 muaj e më pas me pëlqimin e tij i ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 700 euro.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e mbrojtësve të akuzuarit të parashtruara në ankesa për shqiptimin e një dënimi më të butë, me pretendim se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese për të akuzuarin, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate janë të pa bazuara dhe pretendimet e tjera nuk janë të asaj natyre të cilat kishin për të justifikuar dhe ndikuar për një vendim dhe lartësi tjetër nga ai i shqiptuar si në aktgjykimin e ankimuar.

Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi me gjobë i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 41 të KPK-së, që të parandalohet i akuzuarit dhe personat e tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, gjë që edhe nga gjykata e shkallës së parë e kishte parasysh.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2020:105643, dt.11.09.2024**

Procesmbajtësi,

Fitore Zeka

Anëtarët e Kolegjit,

Violeta Husaj Rugova

Skender Çoçaj

Kryetari i Kolegjit,

Zyhdi Haziri